



Pranimi / Dorezimi Punimi / Prodato Bashkimi / Delivery	21-06-2021	1 viti god year
Organ / Baza Organi / Baza Org / Baza	3250/2021	115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.325/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca- kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehemti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2550/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.235/2019 të datës 08.04.2019, të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, kundër organit të punësimit/ Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 21.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.235/2019 e datës 08.04.2019, e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KZKA.Nr.02/2019 i datës 11.03.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror.**

**A r s y e t i m**

Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror, bazuar në Autorizimin e datës 28.12.2018, të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 04.01.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm me numër reference ASNA/REK/002-2019 për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi,

Ankuesi ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit, por i njëjti bazuar në Njoftimin me numër protokoll 028/2019 të datës 29.01.2019, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së

Shërbimit të Navigacionit Ajror (me tej ASHNA), nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm për pozitën përkatëse. Kundër këtij njoftimi, ankuesi me datë 27.02.2019, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të ASHNA-së. Ky i fundit me Vendimin me numër KZKA. 02/2019 të datës 11.03.2019, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

I pakënaqur me Vendimin me numër KZKA 02/2019 të datës 11.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1807/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.04.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Këshilli, me datë 19.04.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2550/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 08.04.2019 të parashtruar nga ankuesi

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 1807/2019 të datës 08.04.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoli 0110 të datës 11.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Strukturën Organizative të Departamentit Meteorologjik; Kërkesën për përgjigje të datës 10.04.2019; Përgjigjen në kërkesë e datës 19.04.2019; Konkursin e Brendshëm të datës 04.01.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit; Autorizimin e DASHC-MAP të datës 28.12.2018; Vendimin për Themelimin e KPSHC-së i datës 15.01.2019; E-malin zyrtar të datës 18.01.2019; Njoftimin e kandidatëve për testimin nga lista e ngushtë; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim i datës 23.01.2019 i ankuesit dhe kandidatit të suksesshëm; E-malin zyrtar të datës 31.01.2019; E-malin zyrtar të datës 25.01.2019; E-malin zyrtar të datës 18.01.2019; E-malin zyrtar të datës 25.01.2019; Raportin final i rekomandimit nga Komisioni Përzgjedhës, Renditjen Përfundimtare të kandidatëve; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Njoftimin e datës 29.01.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe pas shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar,*  
*sepse:*

Ankuesi me ankesën e parashtruar në KPSHCK, pretendon se konkursi i brendshëm për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit në ASHNA është zhvilluar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar provat e lëndës, dhe si rrjedhojë duke iu referuar konkursit të datës 04.01.2019, ka konstatuar së kritere themelore të konkursit për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit", kanë qenë:

- *Te jetë parashikues meteorologjik aeronautik i certifikuar dhe te ketë diplomë universitare në shkencat matematiko natyrore (fizikë, matematikë) ose shkenca tjera (Inxhinieri, Informatikë, Ekonomi).*
- *Duhet te ketë se paku pesë (5) vjet përvojë pune në ketë fushë,*

Nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se shpallja e konkursit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse shpallja e konkursit është bërë në tabelën e shpalljes së ASHNA-së dhe në SIMBNJ, veprim ky në pajtim me nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2011 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: 1. shpallja për avancim bëhet nga njësia e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë.

Lidhur me pretendimin ankimor së për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit nuk është dashur të mbahet fare test me shkrim pasi që grada që posedon ankuesi është vetëm një gradë më e ulët se grada për të cilën ka aplikuar, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 27 i cili ka përcaktuar se: 1. *Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: .....1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale,* e si rrjedhojë Kolegji ka vlerësuar së çdo avancim nga një kategori në një kategori me të lartë drejtuesi duhet të behët përmes procedurës së avancimit gjegjësisht përmes nënshtrimit të procesit të vlerësimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. *Procedura e rekrutimit, të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje zhvillohen, në bazë të hapave në vijim: 1.1 kërkesa për autorizimin e inicimit të procedurës së rekrutimit dhe përgatitja e dosjes së rekrutimit, 1.2 vlerësimi dhe miratimi i kërkesës dhe autorizimit për rekrutim, 1.3. publikimi i njoftimit për rekrutimit, 1.4 vlerësimi i aplikacioneve, identifikimi dhe përzgjedhja e kandidateve,* andaj pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji, po ashtu bazuar në shkresat e lëndës respektivisht nga analizimi i Vendimit të datës 15.01.2019 për Themelimin e Komisionin Përzgjedhës, ka konstatuar se përbërja e Komisionit Përzgjedhës ka qenë në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht është respektuar hierarkia e pozitës si dhe parimi i përfaqësimit gjinor, e mbi këtë konstatim pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se ankuesi nuk është informuar personalisht me rezultatin përfundimtar, Kolegji duke iu referuar shkresave të lëndës ka gjetur se ASHN-ja me datë 29.01.2019 përmes shkresës me numër protokoll 028/2019, ka shpallur njoftimin lidhur me rezultatin përfundimtar dhe shpalljen e kandidatit me të suksesshme për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit", dhe i njëjti është publikuar në tabelën e shpalljeve publike të ASHNA-së.

Përkitazi me pretendimin ankimor së listën e shkurt janë përfshi tre kandidatë por në testin me shkrim dhe gojë kanë qenë vetëm dy kandidatë, Kolegji duke ju referuar shkresave të lëndës si dhe dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenit 29 paragrafi 1 i cili përcakton se: *KSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtër prej se paku tre kandidatëve për përfshirje në listën e shkurtër,...* ka konstatuar së në listën e ngushtë të datës 18.01.2019 janë përfshirë gjithsej tre(3) kandidatë dhe atë \_\_\_\_\_ dhe ankuesi P. \_\_\_\_\_ ndërsa procedurës se mëtejme të vlerësimit i janë nënshtruar vetëm dy kandidatë dhe atë F. \_\_\_\_\_ dhe P. \_\_\_\_\_ e në këtë kuptim pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil, ka vlerësuar si kandidatin me të suksesshëm Fetah Krasniqi me gjithsej 79.40 pikë, e në këtë kuptim Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Po ashtu lidhur me plotësimin e kushteve të Konkursit për pozitën „ Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit, kandidati i zgjedhur F. \_\_\_\_\_ ka plotësuar kriteret e konkursit respektivisht bazuar në Diplomën me numër 1068 të datës 09.09.2009, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, dëshmohet së i njëjti me datë 18.05.1995 ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore-Dega e Fizikes dhe ka marr titullin Profesor i Fizikes, përkitazi me përvojën e punës posedon Vërtetimin me numër reference 849 të datës 05.02.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore më të cilin vërtetohet së F. \_\_\_\_\_ ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij Fakulteti në cilësinë e asistentit në Departamentin e Fizikes, nga data 09.01.1997 deri 30.09.2006 si dhe Vërtetimin e datës 05.01.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike më të cilin vërtetohet se. F. \_\_\_\_\_ është i angazhuar si asistent i lëndës së fizikës I dhe II që nga viti akademik 2008/2009 e të cilën detyrë vazhdon ta kryej me tej. Lidhur me kriterin e Certifikimit si parashikues meteorologjik aeronautik i certifikuar, F. \_\_\_\_\_ posedon Certifikatat e lëshuar nga Met Office Colleague.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe pas shtjellimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e procedurës rekrutuese, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i ASHNA-së, me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër KZKA. 02/2019 të datës 11.03.2019, ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në

Shërbimin Civil, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda A.nr.325/2021**

**Ilire Mehmeti Shaqiri**

**Procesmbajtëse**



**Jeton Koça**

**Kryetar e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

